

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë shqiptarë,

Sot po diskutojmë për energjinë elektrike dhe mënyrën se si trajtohet ky sektor kaq i rëndësishëm për shqiptarët.

Çështja e energjisë elektrike është tepër serioze, ndaj ne duhet të flasim këtu në emër të shqiptarëve dhe për interesat e shqiptarëve. Le të jemi të sinqertë, ne, si deputetë, mund ta përballojmë rritjen e çmimit të energjisë elektrike, por shumica e shqiptarëve nuk ia dalin dot, rritja e çmimit të energjisë i gjunjëzon dhe ua pamundëson pagesën e faturave të kripura të energjisë elektrike. Familjet shqiptare në fund të muajit nuk arrijnë t'i përballojnë kostot e jetesës, rritjen e çmimeve, rritjen abuzive të karburantit, arsimimin e fëmijëve, shërbimin shëndetësor, ndaj shumica detyrohen të marrin borxhe ose të arratisen me gomone drejt Anglisë. Ky është realitet i hidhur shqiptar, realitet dramatik, i cili kërkon vëmendje të veçantë nga ky parlament dhe nga kjo qeveri, e zhytur në krim e korrupsion.

Parlamenti i Shqipërisë, në përmbushje të rolit të tij, si organi që ushtron sovranitetin e popullit, duhet t'i adresojë dhe t'i trajtojë të gjitha shqetësimet e problematikat e qytetarëve që na kanë mandatuar. Nuk mund të jemi këtu as për pasarelë, as për retorikë e fjale boshe, as sa për të marrë rrogën, pasi energjia elektrike është e lidhur ngushtë me jetën e qytetarëve, është e lidhur me sigurinë kombëtare të Shqipërisë.

Siguria energjetike është element kyç i sigurisë kombëtare dhe çdo shtet serioz përpiqet të ndërtojë një strategji për energjinë elektrike, pra përpiqet ta sigurojë energjinë me çmim sa më të ulët dhe për një kohë sa më të gjatë.

Së pari, ne kemi problem strategjik në lidhje me energjinë, në lidhje me politikat për sigurinë energjetike.

Së dyti, ne kemi problem strukturor të administratës dhe personelit të administratës.

Sekretariati i Energjisë, me qendër në Vjenë, e përshkruan qeverinë si të paaftë nga ana strategjike dhe ndër të tjera deklaron: "Shqipëria nuk ka bërë progres për sa i përket reformës në sektorin e energjisë elektrike. Reformat e këtij viti janë vetëm në letër. Reformat strukturore të sektorit duhet të përshpejtohen. Ngecja e tyre po dëmton liberalizimin e sektorit, si kusht i nevojshëm për shëndoshjen financiare të tij. Ka vonesa të mëdha të ndarjes së OSHEE-së në tre kompani të veçanta, sipas direktivave të BE-së, dhe angazhimeve të marra nga qeveria shqiptare për liberalizimin e tregut. Kjo reformë, mbi të gjitha, do të jetë në dobi të konsumatorit familjar.

Shqipëria po vuan mungesën e investitorëve të huaj në energjinë e rinovueshme. Kjo për shkak të politikave qeveritare, klimës së keqe për të bërë biznes dhe mungesës së sigurisë ligjore për kompanitë e huaja në Shqipëri".

Pra, Edi Rama nuk ka pasur ndonjë vullnet për të ndërmarrë politikat e duhura reformatore në lidhje me energjinë. Vëmendja e tij ka qenë te shitblerja e energjisë, ndaj sot gjendemi në këtë situatë tepër të vështirë. Po të kishim ndërmarrë politikat e duhura, do ta përballonim me më pak kosto e kaos këtë krizë energjetike.

Krahas politikës së gabuar të Edi Ramës në fushën e energjisë, kemi edhe problemet me administratën e energjisë elektrike. Kemi abuzime të tmerrshme me faturat e energjisë elektrike. Në Lezhë, në Kurbin dhe në Mirditë bëhen faturime pa e lexuar fare sahatin, faturime me hamendje. Kemi pasur raste të familjeve, të cilat nuk kanë jetuar në banesë për disa muaj, por fatura e energjisë u ka shkuar sikur kanë jetuar, madje edhe kanë konsumuar. Pra, vjedhje e hapur me mekanizmat e shtetit, sepse qeveria e Edi Ramës humbjet në rrjet, humbjet e atyre që nuk paguajnë, sepse janë të lidhur me shtetin, kërkon t'i zëvendësojë dhe t'i kompensojë, duke ua ngarkuar si barrë atyre bizneseve dhe familjarëve, të cilët janë pagues të rregullt. Kjo është vjedhje, është një vjedhje me mirësjellje, ku qytetari i thuhet: "Paguaje njëherë, sepse ka kaluar në sistem dhe më pas ankimoje." Pse duhet të paguajë qytetari diçka që nuk e ka konsumuar, vetëm pse hajdutët e Ramës, militantët e partisë, kanë vendosur t'i heqin paratë nga llogaritë e tyre dhe t'i çojnë në llogarinë e shtetit?!

Krahas mungesës së strategjisë dhe mungesës së vullnetit për të bërë politikat e duhura, mungesës së një administrate korrekte e profesionale, i shtohet edhe rritja e çmimit të energjisë elektrike. Po t'u them se rritja e çmimit është e papërballueshme për familjet shqiptare, kam frikë se do të jetë fjali e përgjithshme dhe nuk do të kuptohet edhe aq mirë. Kështu që po ua ilustroj me shifra:

Nëse një familje në Lezhë (nga ato që mund të quhen me fat) ka të ardhura 500 mijë lekë në muaj ose 700 mijë lekë në muaj, deri sot këto të ardhura i kanë mjaftuar vetëm për ushqime, por nuk i ka tepruar asgjë, me rritjen e çmimit të energjisë nga Edi Rama familja do të paguajë nga 50 deri në 100 mijë lekë në muaj më shumë për energjinë elektrike, gjithashtu do të paguajë edhe 100 mijë lekë më shumë në muaj për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve të shportës. Pra, kësaj familjeje i rriten shpenzimet me 200 mijë lekë shtesë çdo muaj. Ku do t'i gjejë paratë kjo familje për të mbijetuar? A e mendoni ndopak se si do ta kalojë muajin kjo familje? A mund të më përgjigjet dikush prej jush apo nga kabineti i qeverisë? Kjo është për të të ardhur keq, sepse në Lezhë, në Kurbin dhe në Mirditë ka familje, të cilat në fund të ditës shtrijnë dorën për të marrë me listë në marketet e lagjes.

Ndërkohë që shtetet e tjera, shtetet serioze, përfshirë edhe Kosovën, po përpiqen t'i zbusin efektet e krizës energjetike dhe krizës së çmimeve, duke hartuar paketa të ndihmës për popullin, Edi Rama nuk e ka ndër mend të hartojë ndonjë paketë të tillë, sepse paratë e buxhetit të shtetit të shqiptarëve i ka ndarë për bandat dhe oligarkët, të cilëve u jep tenderë, me qellim që ta shpërblejnë kur të vije dita e zgjedhjeve. Pra, paratë e shqiptarëve, të cilat duhet tua ndante shqiptarëve në kohë krize, ua jep bandave elektorale, që ai komandon. Kjo strategji po përgatitet edhe për zgjedhjet vendore në Lezhë, në Kurbin dhe në Mirditë, por, pa dyshim, shqiptarët do ta ndëshkojnë me votë. Faleminderit!